




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr.06/2009 për dhënien në menaxhim të vendgjutive të përbashkëta, nenit 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2022, merr këtë:

VENDIM

për formimin e komisionit për procedurat mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjetisë në territorin e Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komisionit për procedurat të mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjetisë.

Neni 2

Bazuar në nenin 3, paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009 për dhënien dhe menaxhim të Vendgjetive të Përbashkëta, Procedurat për dhënien me qira të vendgjetisë bëhen përmes procedurës së ofertës publike e cila shpallet pas themelimit të vendgjetisë.

Neni 3

Të drejtat dhe detyrat e komisionit caktohen në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009, sipas planeve menagjuese 10 vjeçare, të cilat duhet të hartohen brenda 6 muajsh nga dita e lidhjes së kontratës dhe t'i plotësojnë të gjitha kushtet dhe obligimet që dalin nga neni 39 i Ligjit të Gjjetisë.

Neni 4

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Kemajl Franfu anëtar përfaqësues nga ekzekutivi i Komunës së Vitisë
2. Burim Sadiku anëtar, përfaqësues nga ekzekutivi i Komunës së Vitisë
3. Ekrem Ymeri anëtar përfaqësues nga kuvendi komunal
4. Remzi Salihu anëtar përfaqësues nga kuvendi komunal
5. Tefik Salihu nga shoqëria civile, anëtar.

Neni 5

Menaxhimi i vendgjetisë bëhet me dhënien e tyre në menaxhim në formë të qirasë në afat prej 10 viteve.

Neni 6

Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit Komunal të Vitisë me Nr. 01-110/05-263, i datës 29.04.2021, për formimin e komisionit për procedurat mëtutjeshme të dhënies me qira të vendgjetisë në territorin e Komunës së Vitisë nga arsyeja që ka ndërru përbërja e Kuvendit Komunal në Viti.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë e Komunës së Vitisë.

Neni 8

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë se Bujqësisë, Pylltari....,
2. MAPL-së, dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi